



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER

Nr. 634 Prot.

Fier më, 01.07.2024

Lënda: Njoftim mbi aplikimin për lëvizje paralele me dëshirë, për punonjësit mësimor të punësuar me kontratë me afat të pacaktuar.

Bazuar në Ligjin Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Udhëzimin nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 25.05.2024, shkresën e AKAP nr. 1921/5 prot., datë 28.06.2024 “Mbi procedurën e lëvizjes paralele sipas udhëzimit nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar, njoftojmë fillimin e procedurave të aplikimit për lëvizje paralele sipas afateve të mëposhtme:

Aplikimi i kandidatëve :

- Mësuesi i punësuar me kontratë pune me afat të pacaktuar, që dëshiron të kryejë lëvizje paralele para fillimit të vitit mësimor 2024-2025 brenda ZVAP-së ku është i punësuar, aplikon nga data **01 Korrik 2024- 15 Korrik 2024**.
- Dokumentacioni i aplikantit për lëvizje paralele do të dërgohet në rrugë elektronike, me email në adresën e DRAP-it ku ka varësinë ZVAP-i në të cilin është i punësuar,
- Adresa e emailit ku do të dërgoni dokumentat e aplikimit sipas shtojcës 2 të këtij udhëzimi është si vijon:

DRAP Fier: Levizjeparalele2024.drapfier@arsimi.gov.al

Dokumentacioni i aplikimit :

1. Mësuesit që dëshirojnë të kryejnë lëvizje paralele, dërgojnë në adresën e emailit dokumentacionin e përcaktuar në shtojcën 2 të udhëzimit.

- a) Formulari i aplikimit **(i detyrueshme për t'u ngarkuar)**
- b) kartën e identitetit **(e detyrueshme për t'u ngarkuar)**.
- c) Kopje e diplomës/ave, vërtetimit/listës së notave të studimeve të larta (cikli i parë dhe cikli i dytë) ose të barasvlershme me këto sipas përcaktimeve të kuadrit ligjor në fuqi **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
- d) Kopje e licencës së provimit të shtetit për profesionin e rregulluar të mësuesit, për të gjithë kandidatët që kanë detyrim ligjor ta kryejnë këtë provim sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
- e) Formular të vetëdeklarimit të gjendjes gjyqësore, sipas modelit të shtojcës 3, të këtij udhëzimi; **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
- f) Deklaratë nga kandidati për autorizimin e institucionit arsimor që të shqyrtojë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura sipas modelit të shtojcës 4, të këtij udhëzimi; **(i detyrueshëm për t'u ngarkuar)**.
- g) Kopje e librezës së punës **(e detyrueshme për t'u ngarkuar)**.
- h) Kopje e dëshmimeve të kualifikimit për kategoritë: “Mësues i kualifikuar”, “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtrë” **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë)**.
- i) Kopje e certifikatave me kredite të trajnimeve të kryera brenda dhe jashtë vendit. Certifikatat me kredite të trajnimeve të kryera brenda vendit të jenë ofruar nga MAS, institucionet e varësisë ose nga agjencitë e akredituara. **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet me pikë)**
- j) Kopje e dëshmisë së njohjes së gjuhës/ve të huaja **(nëse ka dhe dëshiron të vlerësohet)**.
- k) Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 5).
- l) Vlerësimi nga punonjësi/it e shërbimit psiko-social, sipas pikës 7 të shtojcës 2
- m) Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, sipas pikës 8 të shtojcës 2

2. Kandidati, dosja e të cilit nuk përmban një nga dokumentet e detyrueshme nuk kualifikohet.

Afatet e njoftimit të kandidatëve:

1. KVD-ja e DRAP-së, brenda datës 22 korrik, vlerëson dosjet e kandidatëve që kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë. Rezultatet e vlerësimit paraprak publikohen në faqen e DRAP-së dhe të ZVAP-së, si dhe i dërgohen me email çdo aplikanti.
2. Kandidati që ka aplikuar për lëvizje paralele brenda të njëjtës ZVAP, ka të drejtë të paraqesë ankesë në DRAP për rezultatin paraprak, brenda 3 (tri) ditëve nga marrja e njoftimit të rezultatit., nga data 23.07.2024-25.07.2024
3. KVD-ja e DRAP-së, brenda 3 (tri) ditëve pune, shqyrton ankesat dhe i njofton me *email* çdo kandidati rezultatin përfundimtar të vlerësimit të dosjes për lëvizje paralele nga data 26.07.2024-30.07.2024
4. KVD-ja e DRAP-së rendit për çdo ZVAP sipas profileve, mësuesit që kanë ngelur pa ngarkesë mësimore dhe mësuesit që kanë bërë kërkesë për lëvizje paralele në të njëjtën

- ZVAP. Këto lista i publikon në faqen zyrtare të DRAP-së, si dhe i dërgon për publikim në ZVAP-në përkatëse brenda datës 31.07.2024.
5. Vendet e lira të punës që janë krijuar brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore (lëvizje paralele e detyruar) brenda datës 02 shtator 2024.
 6. Vendet e lira të punës të mbetura pas lëvizjes paralele me detyrim, brenda një ZVAP-je u ofrohen për punësim mësuesve të cilët kanë aplikuar për lëvizje paralele me dëshirë, sipas profileve dhe renditjes, brenda datës 04 shtator 2024.
 7. Në rast se në ZVAP-të e tjera të DRAP-së rezulton se pas njoftimit për punësim, ka vende të lira pune, atëherë këto vende u ofrohen kandidatëve të papunësuar të të gjitha ZVAP-ve në juridiksion, të cilët kanë ngelur pa ngarkesë mësimore, sipas profileve, duke filluar me kandidatin me më shumë pikë, brenda datës 04 shtator 2024.

Faleminderit për bashkëpunimin.

DREJTORI

Zaira Gjika



FORMULARI I APLIKIMIT PËR LËVIZJET PARALELE

NID*:

Emri*:

Mbiemri*:

Nr. Cel*:

Email*:

DRAP*:

ZVAP*:

Shkolla ku është i/e punësuar*:

Profili* :

SHTOJCA 2

KRITERET DHE SKEMA E VLERËSIMIT TË DOSJEVE TË KANDIDATËVE PËR LËVIZJET PARALELE

1	<p>Nota mesatare e studimeve të larta, e shprehur në numër me një shifër pas presjes dhjetore (nota mesatare e ciklit I + nota mesatare e ciklit II)/2, ose nota mesatare e studimeve të bazasvlershme me to.</p> <p>Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>Nota mesatare 5.00 - 5.50 = 0.5 pikë; Nota mesatare 5.51 - 6.00 = 1 pikë; Nota mesatare 6.01 - 6.50 = 1.5 pikë; Nota mesatare 6.51 - 7.00 = 2 pikë; Nota mesatare 7.01 - 7.50 = 2.5 pikë; Nota mesatare 7.51 - 8.00 = 3 pikë; Nota mesatare 8.01 - 8.50 = 3.5 pikë; Nota mesatare 8.51 - 9.00 = 4 pikë; Nota mesatare 9.01 - 9.50 = 4.5 pikë; Nota mesatare 9.51 - 10.00 = 5 pikë.</p>	0.5–5 pikë
2	<p>Kategoria e kualifikimit:</p> <p>a) Mësues i Kualifikuar (kategoria III) 1–4 pikë (1 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 2 pikë për vlerësimin “Mirë”, 3 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe 4 pikë për vlerësimin “Shkëlqyeshëm”);</p> <p>b) Mësues Specialist (kategoria II) 5–7 pikë (5 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 6 pikë për vlerësimin “Mirë”, 7 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”);</p> <p>c) Mësues Mjeshtër (kategoria I) 8–10 pikë (8 pikë për vlerësimin “Mjaftueshëm”, 9 pikë për vlerësimin “Mirë”, 10 pikë për vlerësimin “Shumë mirë” dhe “Shkëlqyeshëm”)</p> <p>Për kandidatët që nuk e kanë në dëshmi nivelin e vlerësimit, do të llogaritet niveli “Shumë mirë”.</p> <p>Kandidati vlerësohet vetëm për kategorinë më të lartë të kualifikimit që zotëron. Kandidati që nuk ka kategori kualifikimi vlerësohet me zero pikë.</p>	0–10 pikë
3	<p>Dëshmi të njohjes së gjuhës/ve të huaja:</p> <p>a) Gjuhë e huaj e mbrojtur në IAL-të publike = 1 pikë; b) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B1 = 1 pikë; c) Gjuhë e huaj e mbrojtur me testim ndërkombëtar niveli B2 = 2 pikë.</p> <p>Dokumenti i gjuhës së huaj duhet të jetë lëshuar nga subjekte të njohura nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, për ofrimin e testeve ndërkombëtare dhe të jetë brenda afatit të vlefshmërisë. Lista e subjekteve është sipas udhëzimit nr. 52, datë 3.12.2015, i ndryshuar.</p> <p>Pavarësisht se kandidati mund të ketë disa gjuhë të huaja të mbrojtura, në këtë rubrikë nuk mund t’i llogariten më shumë se 2 pikë në vlerësimin e dosjes.</p> <p>Në rast se kandidati ka mbrojtur të njëjtën gjuhë të huaj në dy institucione të ndryshme, do t’i llogariten pikë vetëm për dëshminë me vlerësimin më të lartë.</p> <p>Kandidatit të profilit gjuhë e huaj, i njihen pikët e kësaj rubrike, përveç gjuhës së huaj për të cilën është diplomuar.</p> <p>Kandidati që nuk zotëron dëshmi të gjuhës së huaj, vlerësohet me zero pikë.</p>	0–2 pikë
4	<p>Trajnime. Vlerësimi bëhet sipas kësaj skeme:</p> <p>a) Certifikata trajnimesh me kredite të lëshuara nga institucione në varësi të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit ose nga agjenci trajnuese që janë akredituar nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p> <p>i. 1 kredit = 1 pikë; ii. 2 kredite = 2 pikë; iii. mbi 3 kredite = 3 pikë.</p> <p>Kandidati që nuk zotëron certifikata trajnimi, vlerësohet me zero pikë.</p>	0–3 pikë
5	<p>Përvoja në punë si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor.</p> <p>Kandidati që nuk ja përvojë pune si mësues dhe/ose drejtues institucioni arsimor, vlerësohet me zero pikë.</p>	0–10 pikë (0.25 pikë për çdo vit pune)

6	Vlerësimi i përfaqësuesve të prindërve (sipas shtojcës 5). Përfaqësuesit e prindërve të nxënësve, ku mësuesi jep mësim, vlerësojnë punën e këtij mësuesi me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon: Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë.	0–2 pikë
7	Vlerësimi nga punonjësi/it e shërbimit psiko-social. Punonjësi/it e shërbimit psiko-social vlerësojnë punën e mësuesit me nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët” si vijon: Vlerësimi “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi “Dobët” = 0 pikë.	0–2 pikë
8	Vlerësimi i drejtorit të institucionit arsimor, bazuar në vlerësimin e performancës, e shprehur në nivelet: “Shumë mirë”, “Mirë”, “Mjaftueshëm”, “Dobët”, si vijon: Vlerësimi: “Shumë mirë” dhe “Mirë” = 2 pikë; Vlerësimi: “Mjaftueshëm” = 1 pikë; Vlerësimi: “Dobët” = 0 pikë.	0–2 pikë

SHTOJCA 3

VETËDEKLARIMI I GJENDJES GJYQËSORE

Të dhënat e vetëdeklaruesit:

Emër, atësi, mbiemër: _____

Datëlindja: _____

Vendlindja: _____

Dokumenti i identifikimit (kopje bashkëlidhur formularit)

Deklaroj me vullnetin tim të lirë se jam: _____

i/e padënuar i/e dënuar

Deklaroj me vullnetin tim të lirë, se nuk kam qenë asnjëherë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale kundrejt të miturve apo për kryerjen e një vepre penale, që lidhet me institucionet arsimore, apo i rehabilituar për këto vepra penale.

Emër, mbiemër: _____ Nënshkrimi: _____

SHTOJCA 4

DEKLARATË PËR VERIFIKIMIN E VËRTETËSISË SË DOKUMENTEVE TË PARAQITURA
NGA KANDIDATI

Unë _____, kandidat në procesin e konkurrimit për lëndën/profilin “_____”, të zhvilluar në vitin shkollor _____ - _____, autorizoj DRAP-në _____ të verifikojë në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Deklaroj se të dhënat e paraqitura në këtë formular janë të vërteta dhe autorizoj kontrollin e vërtetësisë së tyre nga institucioni arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

Trajtimi i të dhënave personale në vijim të përdorimit të këtij autorizimi do të bëhet në përputhje me ligjin nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

AUTORIZUESI

SHTOJÇË 5



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR _____

Nr. _____ prot. _____, më _____, 202_

PROCESVERBAL I DOKUMENTIMIT TË OPINIONIT TË KËSHILLIT TË PRINDËRVE PËR
MËSUESIN/EN _____
PROFILI _____,

Sot në datën _____, 202_ ora _____, bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.7.1995, "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; në ligjin nr. 69/2012, datë 21.6.2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe në udhëzimin nr. _____, datë _____, të ministrit të Arsimit dhe Sportit, "Për procedurat e pranimit e të emërimit të mësuesit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë'", u mbledh Këshilli i Prindërve në shkollën _____ për të dhënë opinion për mësuesin/en, z./znj. _____, profili _____, dhe për performancën e tij/saj në procesin mësimor-edukativ, sjelljen dhe etikën në institucionin arsimor.

Në mbledhje morën pjesë _____ prindër nga _____ prindër gjithsej.

Opinion i prindërve mbi mësuesin/en z./znj. _____ është:

1. Dobët 2. Mjaftueshëm 3. Mirë 4. Shumë mirë

Anëtarët e pranishëm në Këshillin e Prindërve:

1. _____ 2. _____ 3. _____

Rezultati i vlerësimit për këtë mësues është: _____

U votua me _____ pro, dhe _____ vota kundër, me votim të fshehtë.

Mbajti procesverbalin

DREJTOR



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____
INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR _____”

Nr _____ Prot _____

_____, më ____ . ____ .202_

VLERËSIMI I PUNONJËSIT TË SHËRBIMIT PSIKO-SOCIAL

- Ky format informon të gjithë drejtuesin e institucionit arsimor për vlerësimin e mësuesit në fushat kryesore të cilat ndikojnë në mirëqenien psiko-sociale të nxënësve si dhe në mbarëvajtjen e procesit mësimor dhe edukativ.
- Shkalla e vlerësimit për çdo tregues paraqitet si më poshtë:

	TREGUESIT	SHKALLËT E VLERËSIMIT		
		MJAFTUESHEM (0)	MIRË (1)	SHUMË MIRË (2)
1	Krijon një mjedis të sigurt dhe të përshtatshëm për procesin e të nxënësve duke krijuar një klimë bashkëpunimi në klasë.			
2	Tregon aftësi në menaxhimin e sjelljeve problematike brenda klasës.			
3	Respekton personalitetin dhe të drejtat e nxënësve duke dhënë shembullin vetjak në të gjitha fushat (fjalor, sjellje komunikim përkushtim në punë).			
4	Respekton diversitetin dhe përkatësinë (kulturore, gjinore, raciale, etnike fetare, aftësisë së kufizuar etj) e nxënësve .			
5	Komunikon në mënyrë efektive me të gjithë aktorët, duke u bazuar tek respekti dhe besimi i ndërsjelltë.			
6	Respekton dhe ruan kofidencialitetin e informacionit/çështjeve personale të nxënësve, me përjashtim të rasteve kur kërkohet jeta apo integriteti i fëmijës.			
7	Afirmon vlerat dhe dinjitetin e nxënësve dhe siguron mbështetje e duhur për nevojat e tyre.			

8	Përdor programe/plane të diferencuara mësimdhënie dhe nxënie, në përshtatje me nevojat e nxënësve.			
9	Mësuesi punon si një anëtar ekipi me kolegët e tij dhe ndan me ta zhvillimin e praktikave të efektshme.			
	VLERËSIMI PËRFUNDIMTAR	0 pikë	1 pikë	2 pikë

- ✦ Mësuesi _____ shfaq norma _____ (të larta/të ulëta) të etikës dhe të sjelljes ndaj nxënësve dhe kolegëve.
- ✦ Vlerësohet me _____ pikë (Mirë/Shumë mirë/dobët)

Punonjës i SHPS _____



MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT

AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR _____

INSTITUCIONI ARSIMOR PARAUNIVERSITAR _____

Nr _____ Prot _____, më _____.202_

VLERËSIMI I DREJTORIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR PËR
MËSUESIN _____ PROFILI _____ SHKOLLA _____

Bazuar në Ligjin nr. 7961, date 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, në Ligjin Nr. 69/2012, datë 21.06.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Udhëzimin nr. 08, datë 03.05.2024, “Për procedurat e pranimit, të pezullimit dhe të largimit të mësuesit nga një vend pune, si dhe administrimit të portalit “Mësues për Shqipërinë”, i ndryshuar me udhëzimin nr. 10, datë 25.05.2024,

Sot në datën _____.202_ në IAP _____ për mësuesin/en, z/Znj _____, profili _____ bazuar në performancën e tij/saj në procesin mësimor-edukativ, zbatimin e ligjshmërisë, sjelljen dhe etikën në Institucionin Arsimor për vitin _____, si drejtues i Institucionit Arsimor Parauniversitar, dokumentoj vlerësimin si më poshtë:

- | | |
|----------------|----------|
| 1. Dobët | (0 pikë) |
| 2. Mjaftueshëm | (1 pikë) |
| 3. Mirë | (2 pikë) |
| 4. Shumë mirë | (2 pikë) |

Rezultati i vlerësimit për këtë mësues është _____ dhe vlerësohet me ____ pikë.

DREJTORI